



## REPUBLIKA E SHQIPËRISE

### GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më datë 28.08.2023

#### **SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE “SPECIALIST ARKIVE”**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për levizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor, vendimit nr.84 dt.11.03.2021 dhe shkresës nr. 1090/21 prot, datë 16.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

#### **I. 1 (NJË) POZICION – SPECIALIST ARKIVE, KATEGORIA IV-2**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civil gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumenteve për **LËVIZJE PARALELE** është më datë **18 SHTATOR 2023;**
- Afati për dorëzimin e dokumenteve për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR** është më datë **25 SHTATOR 2023;**

#### **II. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN SPECIALIST ARKIVE:**

1. Shërbimi i arkivit gjyqësor mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

2. Shërbimi i arkivit gjyqësor bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.
3. Mban protokollin e korrespondencës zyrtare, të zakonshme ose të klasifikuar, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe normative në fuqi në fushën e informimit publik, informacionit të klasifikuar dhe arkivit;
4. Mban dhe administron librat e dorëzimit të shkresave të korrespondencës brenda Gypkatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
5. Përcjell shkresat pa vonesë pas protokollimit, Kryetarit të Gypkatës apo Kancelarit;
6. Kujdeset për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave arkivor, të cilat plotësohen në mënyrë manuale me shkrim të qartë, të pastër e të lexueshëm dhe/ose elektronike;
7. Zbaton aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me fondin arkivor dhe arkivat në Republikën e Shqipërisë;
8. Lëshon kopje të vendimeve të fondit të arkivit të Gypkatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
9. Plotëson, ruan, përgatit dhe jep për shfrytëzim dokumentet, ndjek zbatimin e dispozitave për punën me dokumentet, merr masat për evakuimin për raste fatkeqësish;
10. Dorëzon, sipas rregullave të Arkivit Qendror të Shtetit dokumentet me afat ruajtjeje të përhershme;
11. Kujdeset për asgjësimin e dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, sipas afateve, me komision, sipas ligjit.
12. Kujdeset për mirëmbajtjen e arkivit të shkresave që hyjnë e dalin në dhe nga Gypkatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
13. Kujdeset për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave arkivor, të cilat plotësohen në mënyrë manuale me shkrim të qartë, të pastër e të lexueshëm dhe/ose elektronike;
14. Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Kancelari.

### **III. LËVIZJA PARALELE**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

### **IV. KUSHTET PËR LEVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të jetë diplomuar në Drëjtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
2. Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

## **VI. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) (“Vende vakante”).
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) (“Vende vakante”).
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- d. Fotokopje të noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (Kartë Identiteti);
- f. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore sipas formularit tip të publikuar në faqen zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) (“Vende vakante”).
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, brenda datës **18 SHTATOR ora 16:00**.

Ankesat nga kandidatet e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 diteve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

## **V. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **19 SHTATOR 2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të Këshilli i Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të çdo Gjykate, listën e kandidateve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

## **VI. MËNYRA E VLERESIMIT TË KANDIDATËVE**

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemi pikëzimi. Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vleresimit në punë;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e Drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me

fushën e pozicionit përkatës;

c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse.

## **VII. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

## **VIII. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Ketë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe të Gjykatës duke filluar nga data **20 SHTATOR 2023**.

## **IX. KUSHTET QË DUHET TË PLOTESOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA**

Sipas nenit 55 të Ligj 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatet jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligj 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose cdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

## **X. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

1. Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron;
2. Curriculum Vitae` të përditësuar;
3. Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (Kartë Identiteti);
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore)
8. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
11. Vërtetim banimi (saktësim adrese);
12. Dëshmi penaliteti.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, brenda datës **25 SHTATOR 2023, ora 16:00.**

## **XI. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **26 SHTATOR 2023**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykate listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan brenda 2 diteve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

## **XII. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTESITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA.**

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- b. Ligj nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- c. Ligj 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
- d. Ligj nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- e. Ligj nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftesitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;

- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **XIII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për testimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në përfundim të vlerësimit të kandidateve, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit për rezultatet. Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Gjykatës, për fazat e metejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzim nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij [www.Klgj.al](http://www.Klgj.al).

## **GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**

### **E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**